



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 106, Datë, 19.05.2022

MBI  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRDORIMIT TË TERMINALIT TË  
GAZIT NATYROR TË LËNGSHËM (GNL)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 16, 17 dhe 74, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 16, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.05.2022, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë teknike me nr. 668/8 prot., datë 17.05.2022, “Mbi miratimin e Rregullores së përdorimit të terminalit të Gazit Natyror të Lëngshëm (GNL)”,

**Konstatoi se:**

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 268, datë 28.12.2020, u vendos fillimi i procedurës për miratimin e “Rregullores për përdorimin e terminalit të Gazit Natyror të lëngshëm (Rregullorja e GNL-së)”.
- Me shkresën nr. 6/3 prot., datë 08.01.2021, u publikua njoftimi në median e shkruar për 2 ditë me radhë në Gazetat “Tema” dhe “Panorama”, me qëllim mbledhjen e opinionëve dhe sygjërimeve nga palët e interesit.
- Gjithashtu me shkresën nr. 39 prot., datë 11.01.2021, ERE i kërkoi palëve të interesit: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar, Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit, Shoqatës “Konsumatori në fokus”, Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, “Albpetrol” sh.a., “Albgaz” sh.a., “Phoenix Petroleum” sh.a., “C.G.C” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “TAP AG Albania” sh.p.k., “GSA” sh.p.k. dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të dërgojnë opinionet dhe sugjerimet në lidhje me këtë draft rregullore.
- Rezulton se MIE, me anë të shkresës nr. 423/1 prot., datë 28.01.2021, protokolluar në ERE me shkresën nr. 39/1 prot., datë 01.02.2021, u shpreh parimisht dakort për fillimin e procedurës mbi miratimin e Rregullores dhe nuk ka patur propozime të tjera konkrete nga palët e interesit të cituara më sipër.

- Sekretariati i Energjisë ka përcjellë me email-in e datës 25 shkurt 2021, opinionin e tij në lidhje me draft Rregulloren, si dhe nuk ka patur propozime të tjera konkrete nga palët e interesit të cituara më sipër.
- Sipas dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, operimi i sistemeve të GNL-së kryhet nga operatorët e sistemit të GNL-së, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE. Nisur nga kriteri i efikasitetit dhe bilancit ekonomik, mund të ketë një ose më shumë operatorë të GNL-së.
- Rregullorja e përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm, është zhvilluar duke ndjekur parimet e përgjithshme të transparencës, mosdiskriminimit të përdoruesve të terminalit, sigurisë dhe besueshmërisë së Terminalit, si dhe efikasitetit teknik dhe ekonomik të funksionimit të Terminalit.
- Rregullorja përcakton Termat dhe kushtet e përgjithshme të përdorimit të Terminalit të Gazit Natyror të Lëngshëm dhe Politikën e Alokimit të Gazit Natyror.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë Rregulloren e përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL), bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Drejtoria Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**